



# **FLETORJA ZYRTARE**

## **E**

# **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**Nr. 55**

**2001**

**Dhjetor**

### **P Ë R M B A J T J A**

|                                        | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i KM<br>nr.610, datë 12.11.2001 | Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Bulqizës ..... 1717                                                                                                                                      |
| Vendim i KM<br>nr.615, datë 2.11.2001  | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.288, datë 18.6.1999 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me vendimin nr.311, datë 5.7.1999 të Këshillit të Ministrave..... 1718 |
| Vendim i KM<br>nr.621, datë 12.11.2001 | Për rialokim fondesh në Buxhetin e Shtetit të vitit 2001 për disa institucione..... 1719                                                                                                                                                                                                |
| Vendim i KM<br>nr.622, datë 12.11.2001 | Për përcaktimin e zonave ku mund të hapen kazino..... 1720                                                                                                                                                                                                                              |

|                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |      |
|-----------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.625, datë 12.11.2001  | Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregullat për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të autorizuar, të miratuara me vendimin nr.150, datë 30.3.2000 të Këshillit të Ministrave.....                                                                                                                                                    | 1721 |
| Vendim i KM<br>nr.627, datë 12.11.2001  | Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Fierit.....                                                                                                                                                                                                                        | 1726 |
| Vendim i KM<br>nr.630, datë 12.11.2001  | Për vendosjen e kufizimeve në shitjen e mallrave në magazinat doganore të tipit "C", "Duty Free Shops".....                                                                                                                                                                                                                                                       | 1727 |
| Vendim i KM<br>nr.632, datë 21.11.2001  | Për mënyrën e pagesës së banesës që të verbrit e grupit të parë përfitojnë nga Enti Kombëtar i Banesave.....                                                                                                                                                                                                                                                      | 1727 |
| Vendim i KM<br>nr.634, datë 21.11.2001  | Për një ndryshim në vendimin nr.775, datë 28.10.1996 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit", ndryshuar me vendimin nr.77, datë 2.3.2000 të Këshillit të Ministrave.....                                                                                                                                                           | 1728 |
| Vendim i KM<br>nr. 635, datë 21.11.2001 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 337, datë 15.7.1999 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Komisionit Qeveritar për Problemet Ujore me Vendet Fqinje".....                                                                                                                                                                                                 | 1729 |
| Vendim i KM<br>nr.636, datë 21.11.2001  | Për privatizimin e banesave të familjeve të shpërngulura nga ndërtimi i hidrocentralit të Banjës.....                                                                                                                                                                                                                                                             | 1730 |
| Vendim i KM<br>nr.638, datë 21.11.2001  | Për një ndryshim në vendimin nr.64, datë 2.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për inkuadrimin e gradave ushtarake në gradat e Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e funksioneve që do të ushtrohen sipas tyre".....                                                                                                                                               | 1733 |
| Vendim i KM<br>nr. 640, datë 22.11.2001 | Për pagat e Avokaturës së Shtetit.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 1747 |
| Vendim i KM<br>nr. 641, datë 22.11.2001 | Për disa shtesa në vendimin nr. 299, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave "Për regjistrimin për shitje të sipërfaqeve të trojeve të objekteve në pronësi të shoqërive huamarrëse në administrim".....                                                                                                                                                        | 1748 |
| Vendim i KM<br>nr.644, datë 21.11.2001  | Për disa ndryshime në vendimin nr.481, datë 19.7.2001 të Këshillit të Ministrave "Për pranimet në shkollat e larta për vitin akademik 2001-2002 në sistemin me shkëputje nga puna, si edhe tarifën e shkollimit po për vitin akademik 2001-2002", të ndryshuar me vendimin nr.566, datë 22.10.2001 të Këshillit të Ministrave.....                                | 1749 |
| Vendim i KM<br>nr.648, datë 22.11.2001  | Për disa shtesa në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001; nr.158, datë 22.3.2001; nr.167 datë 30.3.2001; nr.174, datë 30.3.2001; nr.197, datë 6.4.2001; nr.385, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave..... | 1749 |

|                                        |                                                                                                                                                                                                                        |      |
|----------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.653, datë 21.11.2001 | Për kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë, të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime "Albtelecom".....                                                                                 | 1750 |
| Vendim i KM<br>nr.654, datë 21.11.2001 | Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës", miratuar me vendimin nr.394, datë 27.7.2000 të Këshillit të Ministrave..... | 1751 |
| Vendim i KM<br>nr.656, datë 21.11.2001 | Për shtesë pensioni të posaçëm shtetëror.....                                                                                                                                                                          | 1752 |
| Udhëzim i KM<br>nr.7, datë 21.11.2001  | Për një ndryshim në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", ndryshuar me udhëzimin nr.4, datë 17.5.2001 të Këshillit të Ministrave.....    | 1753 |

**V E N D I M**  
**Nr. 610, datë 12.11.2001**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E BULQIZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Bulqizës.
  2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Bulqizës.
  3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 3575 m<sup>2</sup> tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 1 144 000 (një milion e njëqind e dyzet e katër mijë) lekësh.
  4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
  5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit janë në ngarkim të Bashkisë së Bulqizës, kërkesit për shpronësim, në shumën 105 000 (njëqind e pesë mijë) lekë.
  6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 15 deri më 30 nëntor 2001.
  7. Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Bulqizës.
  8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Dibrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA BULQIZË**

| Nr. | Emri, atësia, mbiemri | Sipërfaqja<br>m <sup>2</sup> | Çmimi<br>lek/m <sup>2</sup> | Vlera<br>lekë |
|-----|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|---------------|
| 1   | Lime Ahmet Cupi       | 3575                         | 320                         | 1 144 000     |

**V E N D I M**  
**Nr. 615, datë 2.11.2001**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.288, DATË 18.6.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË TELEKOMUNIKACIONEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.311, DATË 5.7.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi, të dokumentit të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.288, datë 18.6.1999 të Këshillit të Ministrave.

2. Vendimi nr.311, datë 5.7.1999 i Këshillit të Ministrave shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

Shtesat dhe ndryshimet e dokumentit "politika e zhvillimit të telekomunikacioneve në republikën e Shqipërisë"

1. Pika 2 "Objektivat afatmesme", tek objektivi "të stimulohet ofrimi i shërbimeve të reja" të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Infrastruktura globale e informacionit, e bazuar në teknologjitë e reja të telekomunikacioneve dhe kompjuterave, krijon kushtet për sigurimin e një shkalle të madhe të shërbimeve të reja.

Me qëllim realizimin e një roli kyç të sektorit të telekomunikacioneve dhe infrastrukturës së shërbimeve të tyre për zhvillimin e shoqërisë së informacionit qeveria do të mbështesë hartimin në të ardhmen të politikave dhe, mbi bazën e tyre, të akteve, ligjore dhe nënligjore, që do të shërbejnë për garantimin e zhvillimit të shoqërisë së informacionit në Shqipëri."

2. Paragrafi i dytë i pikës 4 "Privatizimi" të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Qeveria ka vendosur të kërkojë një partner strategjik për Altelecom, sh.a.-në nëpërmjet një tenderi ndërkombëtar, shpallja e të cilit është planifikuar të bëhet brenda vitit 2001. Qeveria nuk synon të mbajë kontrollin e shoqërisë."

3. Pas pikës 4 "Privatizimi" të shtohen paragrafet me këtë përmbajtje:

"Gjithashtu, qeveria do të nxjerrë aktet e nevojshme që, në çastin e privatizimit të Altelecom sh.a.-së, blerësit e paketës së aksioneve të Altelecom sh.a.-së t'i jepet një licencë për ofrimin e shërbimit celular. Lincenca do t'i jepet një shoqërie të re të zotëruar nga blerësit dhe shërbimi do të lejohet të ofrohet vetëm pas datës 31 dhjetor 2002.

Për këtë qëllim, në dokumentet e tenderit të hapur ndërkombëtar për privatizimin e Altelecom sh.a.-së, bashkë me shitjen e paketës së aksioneve të shoqërisë, do të përfshihet edhe dhënia e licencës për ofrimin e shërbimit të GSM-së.

Për të siguruar konkurrencën e ndershme në tregun e telekomunikacioneve, me privatizimin e Altelecom sh.a.-së, duhet të sigurohet operimi i tre operatorëve GSM, në kushte të barabarta marrëveshjeje në raport me Altelecom sh.a.-në".

4. Pas paragrafit të dytë të pikës 8 "Zonat rurale" të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Altelecom-it do t'i kërkohej që, në fund të vitit 2004, 5 për qind e përdoruesve të shërbimeve të tij, të palëvizshëm, të jenë banorë të zonave rurale, të shpërndarë proporcionalisht në të gjithë territorin e vendit. Për këtë qëllim, si dhe për të mbështetur operatorët ruralë, në përfundim të vitit 2004 Altelecom sh.a.-ja duhet të sigurojë akses në rrjetin e vet nëpërmjet lidhjeve me kapacitet jo më të vogël se 2 Mbit/s (30 linja) në çdo qendër komune."

5. Paragrafi i tretë i pikës 8 "Politikat e licencimit për shërbime publike" të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Procedurat e licencimit do të zbatohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Qeveria do të përcaktojë numrin e licencave që do të jepen për shërbimet e klasifikuara në kategorinë e parë të tabelës së përmendur më sipër. Edhe me hapjen e plotë të tregut të telekomunikacioneve për konkurrencë, pas datës 31 dhjetor 2002, disa shërbime do të vazhdojnë të ekzistojnë në këtë kategori, ku numri i licencave është i kufizuar. Një klasifikim i tillë do të bëhet për ato shërbime që përdorin burime të kufizuara natyrore, siç janë frekuencat."

6. Paragrafët e dytë dhe të tretë të pikës 13 "Menaxhimi i frekuencave" të ndryshohen si më poshtë vijojnë:

"Dhënia e frekuencave nga ERT-ja ndaj përdoruesve civilë do të bëhet në përputhje me

përcakitmet e Planit Kombëtar të Radiofrekuencave. Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve do të ndjekë zhvillimet botërore më të fundit përsa u përket radiokomunikacioneve dhe do të bëjë propozimet përkatëse për të reflektuar në këtë plan vendimet më të fundit të ITU-së, CEPT-së dhe direktivat e Bashkimit Europian.

Për të siguruar në të ardhmen një numër, mundësisht, sa më të madh operatorësh celularë, është i domosdoshëm përdorimi sa më i frytshëm i brezave të radiofrekuencave të caktuara për shërbimet publike celulare, të cilët janë një burim natyror i kufizuar. Për këtë qëllim, dhënia në të ardhmen nga ERT-ja e licencave për shërbimet celulare, si dhe e brezave përkatës të radiofrekuencave për sigurimin e këtyre shërbimeve do të bëhet me procedura tenderi apo ankandi. ERT-ja do të garantojë që operatorët celularë të operojnë në kushte të njëjta."

7. Paragrafi i dytë i pikës 11 "Rregullimi i tarifave" të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Për Albtelecom sh.a.-në çmimi tavan do të zbatohet ndaj të gjithë elementëve të shërbimeve telefonike bazë. Për më tepër, do të ketë kontrolle specifike ndaj tarifave për pagesat mujore dhe bisedat lokale. Mekanizmi i saktë do të specifikohet në licencë. Ky mekanizëm çmimi tavan do t'i mundësojë Albtelecom-it të rregullojë çmimet e veta drejt kostos duke filluar nga viti 2001."

## **V E N D I M**

### **Nr. 621, datë 12.11.2001**

#### **PËR RIALOKIM FONDESH NË BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2001 PËR DISA INSTITUCIONE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 14 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

#### **V E N D O S I:**

1. Agjencisë Telegrafike Shqiptare, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, t'i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milion) lekësh në zërin "Investime".
  2. Institutit të Statistikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, t'i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh në zërin "Investime".
  3. Efektet financiare prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh t'i pakësohen fondit të miratuar për vitin 2001, në zërin "Investime", të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.
  4. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Instituti i Statistikës dhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

## **V E N D I M**

### **Nr. 622, datë 12.11.2001**

#### **PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE KU MUND TË HAPEN KAZINO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Zonat e përcaktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku mund të hapen kazinotë janë si më poshtë vijojnë:

- a) Zona bregdetare turistike e Vlorës;
- b) zona bregdetare turistike e Sarandës;
- c) zona bregdetare turistike e Durrësit;
- ç) qyteti i Tiranës;
- d) zona turistike e Velipojës.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 625, datë 12.11.2001**

**PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR, TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR.150, DATË 30.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 167-8 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregullat për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të autorizuar, të miratuara me vendimin nr.150, datë 30.3.2000 të Këshillit të Ministrave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR, TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR.150, DATË 30.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Neni 1

Neni 1 i rregullave të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 1

Ekspert kontabël i autorizuar është ai profesionist i pavarur, i cili, duke qenë i regjistruar në listën e parashikuar në nenin 43 për këto rregulla, ushtron si profesion kryerjen e kontrollit të shoqërive tregtare, ndërmarrjeve apo organizatave të tjera, të cilat detyrohen nga ligji për këtë kontroll ose e kërkojnë vetë atë.

Ekspert kontabël i autorizuar kryen, gjithashtu, misionet e tjera të parashikuara për të në ligjin "Për shoqëritë tregtare" ose në ndonjë ligj tjetër të veçantë. Ai mund të kryejë si veprimtari dytësore çdo mision tjetër brenda fushës së profesionit, me përjashtim të atyre që bien në kundërshtim me

pavarësinë e tij ose që me ligj i janë rezervuar një profesioni tjetër."

#### Neni 2

Paragrafi i parë i nenit 4 të shfuqizohet.

#### Neni 3

Neni 27 të ndryshohet si më poshtë vijon:

#### "Neni 27

Komisioni i disiplinës përbëhet nga pesë anëtarë:

- një kryetar jurist, i caktuar nga Ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë;
- një anëtar, i caktuar nga Ministri i Drejtësisë;
- një anëtar, i caktuar nga Ministri i Financave;
- një anëtar, profesionist i kualifikuar në fushën e drejtimit të sipërmarrjeve, i caktuar nga Kryetari i Dhomës së Tregtisë;
- një ekspert kontabël i autorizuar, i caktuar nga Këshilli i Drejtimit të Institutit."

#### Neni 4

Fjalja e parë e paragrafit të parë të nenit 33 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Vendimet e Këshillit të Drejtimit të Institutit, me përjashtim të vendimeve për standardet profesionale, për emërimet dhe për buxhetin, janë të zbatueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ana e "Përfaqësuesit të mbikëqyrjes."

#### Neni 5

Pika 6 e nenit 35 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"6. Të ketë kryer stazhin profesional prej tre vjetësh pranë një eksperti apo një shoqërie ekspertësh kontabël të autorizuar."

#### Neni 6

Neni 36 të ndryshohet si më poshtë vijon:

#### "Neni 36

Auditues të huaj, persona fizikë, dhe shoqëri të huaja të auditimit, që dëshirojnë të kryejnë kontrollin ligjor të llogarive të shoqërive tregtare apo të organizatave ekonomike të tjera të vendosura në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen, paraprakisht, në listën e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Audituesit e huaj, persona fizikë, regjistrohen në qoftë se provojnë që e kanë fituar titullin e audituesit, sipas kushteve të njëjtave me ekspertët kontabël vendas, nuk janë të prekur nga ndonjë masë që u ndalon ushtrimin e profesionit, kanë kaluar me sukses një provim për të drejtën shqiptare në masën që i intereson profesionit dhe kur angazhohen se do të jenë të pranishëm në Shqipëri për kohën e kryerjes së misionit.

Shoqëritë e huaja të auditimit regjistrohen në qoftë se janë shoqëri profesionale, janë të themeluara në pajtim me legjislacionin e shtetit të origjinës dhe janë të autorizuar nga ky legjislacion për kontrollin ligjor të llogarive.

Shoqëritë e huaja të auditimit mund të veprojnë sipas njëres prej mënyrave të mëposhtme:

a) Duke siguruar, për kohën e kryerjes së misionit, praninë në Republikën e Shqipërisë të audituesve, persona fizikë;

b) duke pasur të vendosur në Republikën e Shqipërisë një degë, agjenci apo zyrë, që nuk ka statusin e një shoqërie filiale;

c) duke themeluar e regjistruar në Republikën e Shqipërisë një shoqëri-filiale të zotëruar 100 për qind nga një apo më shumë shoqëri auditimi të huaja.

Në çdo rast, kontrolli ligjor i llogarive të kryhet nga dhe/ose nën përgjegjësinë e audituesve, persona fizikë, që janë anëtarë ose të punësuar të shoqërisë së huaj të auditimit, pa përjashtuar përgjegjësinë e vetë shoqërisë.

Komisioni i regjistrimit përcakton dokumentet që shoqërojnë kërkesën për regjistrimin e audituesve të huaj, persona fizikë, dhe të shoqërive të huaja të auditimit, kur këto do të veprojnë sipas shkronjave "a" dhe "b" të përmendura më sipër; kur shoqëria e huaj e auditimit do të veprojë me anë të një shoqërie filiale sipas shkronjës "c" të përmendur më sipër, të zbatohen dispozitat e nenit 37 të kësaj rregullave.

#### Neni 7

Në fund të paragrafit të katërt të nenit 38 të shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Personi i quajtur i "tërhequr zyrtarisht" mund të kërkojë reregjistrimin në listë, në kushtet e nenit 47 të kësaj rregullave."

#### Neni 8

Paragrafi i dytë i nenit 43 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Lista hartohet sipas rendit alfabetik me tregimin, për çdo ekspert kontabël të autorizuar, të vitit të regjistrimit fillestar. Ajo është e ndarë në tre seksione: seksioni i parë për personat fizikë, seksioni i dytë për shoqëritë vendase dhe seksioni i tretë për shoqëritë e huaja. Lista e dytë përmban përveç të tjerash, emrat e adresat e ortakëve apo të aksionerëve dhe anëtarëve të organeve të drejtimit e të mbikëqyrjes. Lista e tretë përmban, emërtimin dhe adresën e selisë së shoqërive audituese të huaja dhe në rastin e zyrës së përfaqësimit apo filialit të ngritur në Republikën e Shqipërisë, si dhe emrin e adresën e personave përgjegjës të shoqërisë, të zyrës së përfaqësimit apo filialit. Këto shoqëri paraqiten në listë të ndara në tre grupe, sipas mënyrës së kryerjes së misioneve, siç është trajtuar në nenin 36 të kësaj rregullave."

#### Neni 9

Pas paragrafit të tretë të nenit 49 të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Provimet organizohen e mbikëqyren nga një juri e posaçme e caktuar sipas nenit 50 të kësaj rregullave. Kjo juri miraton edhe programet e disiplinave të përmendura më sipër."

#### Neni 10

Në nenin 58 të bëhen këto ndryshime:

a) Fjalia e fundit e paragrafit të parë të riformulohet si më poshtë vijon:

"Këshilli i Drejtimit organizon një herë në vit, në kohën dhe sipas modaliteteve të përcaktuara nga ai vetë, kontrollin për mbajtjen e regjistrave profesionalë dhe të dosjeve nga ekspertët kontabël të autorizuar."

b) Paragrafi i dytë të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Mosmbajtja si duhet e dosjeve dhe e regjistrave profesionalë nga ekspertët kontabël të autorizuar ndëshkohet me ndalim të përkohshëm të ushtrimit të profesionit për një periudhë kohe deri në gjashtë muaj. Kjo masë merret nga Këshilli i Drejtimit. Në rast përsëritjeje, çështja i përcillet komisionit të disiplinës, i cili vepron sipas procedurave të parashikuara në kapitullin 9 të kësaj rregullave."

#### Neni 11

Në nenin 62 të shtohen fjalët:

"Për shoqëritë e huaja, kuota profesionale të caktohet nga Ministri i Financave, sipas të njëjtave kriterë të përcaktuara dhe për shoqëritë vendase."

Neni 12

Neni 67 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 67

Çdo shkelje e ligjeve dhe akteve nënligjore, e statutit dhe e rregullave të brendshme të Institutit, e rregullave dhe e standardeve profesionale, çdo neglizhencë e rëndë e çdo fakti që bie në kundërshtim me bindjen ose nderin, të lejuara nga një ekspert kontabël i autorizuar, person fizik apo shoqëri, ose përbën një faj të ndëshkueshëm nga një masë disiplinore, ose penale dhe kur këto shkelje, neglizhenca apo akte nuk lidhen me ushtrimin e profesionit. Kur shkeljet përbëjnë vepër penale zbatohet neni 168 i Kodit Penal."

Neni 13

Neni 69 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 69

Ekspertët kontabël, të pezulluar ose të fshirë nga lista, duhet t'i kthejnë shoqërive që kontrollojnë dokumentet që ata mbanin për këto shoqëri, si dhe shumat e marra, të cilat nuk i përgjigjen një pune efektive të kryer apo shpenzimeve të rimbursueshme."

Neni 14

Pas paragrafit të pestë të nenit 81 të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:  
"Honoraret paguhet në të holla dhe përjashtojnë çdo shpërblim tjetër."

Neni 15

Neni 82 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 82

Këshilli i Drejtimit të Institutit duhet të mbikqyrë, që përcaktimet për orët e punës dhe honoraret të zbatohen me korrektësi.

Kur orët e punës apo honoraret gjykohen të tepërta nga shoqëritë ose të pamjaftueshme nga eksperti, kur nuk bie dakord ndërmjet tyre, çështja i përcillet Këshillit të Drejtimit, i cili duhet të vendosë brenda një muaji.

Vendimi i Këshillit të Drejtimit mund të bëhet objekt kundërshtimi nga secila palë, pranë Komisionit të Disiplinës, i cili duhet të vendosë, gjithashtu, brenda një muaji."

Neni 16

Neni 83 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 83

Për çdo mision të propozuar, eksperti ose ekspertët kontabël, të autorizuar, hartojnë një program të shkruar. Në programin e misionit përshkruhen punët verifikuese dhe punët apo veprimet e tjera të nevojshme për përmbushjen si duhet të qëllimit të misionit, përfshirë edhe ato për planifikimin, kontaktimet dhe raportimet për misionin.

Për çdo punë verifikuese dhe veprim tjetër, që përmban programi, caktohet numri i orëve të punës, i cili, kur është rasti, paraqitet edhe i ndarë sipas bashkëpunëtorëve që do të marrin pjesë në realizimin e programit. Ky program do të përmbajë edhe shumën e honorareve, si dhe shumën e parashikuar të shpenzimeve të rimbursueshme.

Programi i misionit vendoset dhe ruhet në dosjet e parashikuara nga neni 58 i këtyre rregullave.

Mungesa e programit të misionit ndëshkohet në pajtim me paragrafin e dytë të nenit 58 të këtyre rregullave."

#### Neni 17

Neni 84 të ndryshohet si më poshtë vijon:

#### "Neni 84

Numri i orëve të punës për kontrollin ligjor të llogarive gjatë një ushtrimi duhet të jetë normalisht sipas shifrave të treguara më poshtë:

| Shuma totale e bilancit dhe e të ardhurave nga veprimtaria pa tatimin mbi vlerën e shtuar | Numri normal i orëve të punës |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|
| - Deri në 40 milionë lekë                                                                 | 20-35                         |
| - Nga 40 milionë deri në 100 milionë lekë                                                 | 30-50                         |
| - Nga 100 milionë deri në 200 milionë lekë                                                | 40-60                         |
| - Nga 200 milionë deri në 400 milionë lekë                                                | 50-80                         |
| - Nga 400 milionë deri në 1 miliardë lekë                                                 | 70-120                        |
| - Nga 1 miliardë deri në 2 miliardë lekë                                                  | 100-200                       |
| - Nga 2 miliardë deri në 6 miliardë lekë                                                  | 180-360                       |
| - Nga 6 miliardë deri në 16 miliardë lekë                                                 | 300-700                       |

Kufijtë që tregohen në këtë tabelë nuk janë të zbatueshme për:

1. personat juridikë, totali i shumës së bilancit dhe i të ardhurave pa TVSH-në i të cilëve është mbi 16 miliardë lekë;
2. shoqëritë që emetojnë letra me vlerë të regjistruara në kuotën zyrtare të bursës së letrave me vlerë;
3. bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet apo organizatat e ngjashme;
4. shoqëritë e sigurimeve dhe/ose risigurimeve;
5. fondet e investimeve dhe organizatat e ngjashme me to.

Për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, shuma e honorareve caktohet me marrëveshje ndërmjet ekspertit kontabël të autorizuar dhe personit juridik duke pasur parasysh rëndësinë efektive të punëve për përmbushjen e misionit të kontrollit ligjor të llogarive."

#### Neni 18

Neni 85 të ndryshohet si më poshtë vijon:

#### "Neni 85

Këshilli i Drejtimit të Institutit përcakton tarifën orare për punën normale të kontrollit ligjor të llogarive dhe ia paraqet këtë tarifë për miratim Ministrit të Financave. Kjo tarifë është e zbatueshme nga 1 janari i çdo viti.

Tarifa orare e miratuar si më sipër nuk është e detyrueshme për shoqëritë e huaja, por këto shoqëri nuk kanë të drejtë të zbatojnë një tarifë më të ulët."

#### Neni 19

Neni 88 shfuqizohet.

Neni 20

Neni 91 shfuqizohet.

Neni 21

Këto shtesa dhe ndryshime hyjnë në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr. 627, datë 12.11.2001**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë të paluajtshme të pronarëve, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Fierit.
  2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Fierit.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 16 050 m<sup>2</sup> tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 5 136 000 (pesë milionë e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekësh.
  4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
  5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Fierit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 106 000 (njëqind e gjashtë mijë) lekë.
  6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 15 deri më 30 nëntor 2001.
  7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar kryhet nga Bashkia e Fierit.
  8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Fierit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT TË FIERIT**

| Nr | Emri, aësia, mbiemri | Sipërfaqja tokë/m <sup>2</sup> | Njësia lek/m <sup>2</sup> | Vlera Lekë |
|----|----------------------|--------------------------------|---------------------------|------------|
| 1  | Besim Zenko Arapi    | 8970                           | 320                       | 2 870 400  |
| 2  | Dalip Zenko Arapi    | 5110                           | 320                       | 1 635 200  |
| 3  | Zenko Idriz Arapi    | 1970                           | 320                       | 630 400    |
|    | Shuma në lekë        |                                |                           | 5 136 000  |

**V E N D I M**  
**Nr. 630, datë 12.11.2001**

**PËR VENDOSJEN E KUFIZIMEVE NË SHITJEN E MALLRAVE NË MAGAZINAT  
DOGANORE TË TIPIT "C", "DUTY FREE SHOPS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 82 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8473, datë 14.9.1999 me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Magazinat doganore të tipit "C" , "Duty free shops" lejohen t'u shesin mallin duhan dhe produktet e tij vetëm udhëtarëve mbi moshën 15 vjeç, që kalojnë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në bazë të kufizimit sasior për çdo udhëtar, si më poshtë vijon:

- i) dy steka cigare;
- ii) 100 cigarillo (cigare me peshë maksimale prej 3 gramë secila);
- iii) 100 puro;
- iv) 250 gramë duhan.

2. Magazinat doganore të tipit "C" , "Duty free shops" lejohen t'u shesin mallin pije alkoolike, verë dhe birra, vetëm udhëtarëve mbi moshën 18 vjeç që kalojnë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në bazë të kufizimit sasior, për çdo udhëtar, si më poshtë vijon:

dy litra pije të distiluara dhe alkool me fortësi alkoolike ndaj volumit më të lartë se 22 për qind ose alkool etilik i padenatruar me forcë alkoolike ndaj volumit 80 për qind dhe më shumë;

(ii) 3 litra pije të distiluara dhe alkool, aperitivë me bazë vere ose alkooli ose pije të ngjashme me fortësi alkoolike ndaj volumit që nuk i kalon 22 për qind ose verë të gazuar, likere;

(iii) 3 litra verë të zakonshme.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 632, datë 21.11.2001**

**PËR MËNYRËN E PAGESËS SË BANESËS QË TË VERBRIT E GRUPIT TË PARË  
PËRFITOJNË NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 dhe 17 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave për trajtimin me përparësi nga shteti, të planifikojë fonde për strehimin e të verbërve të grupit të parë, në bazë të kërkesës së Shoqatës të së Verbërve të Shqipërisë.

2. Çdo i verbër i grupit të parë përfiton falas një dhomë me sipërfaqe 12.5 -14 m2 mbi sipërfaqen normative dhe përshtatjen e banesës sipas kushteve fizike. Për banesat që do t'u jepen qytetarëve me statusin e të verbrit të përdoren normat ekzistuese të projektimit deri në nxjerrjen e normave të projektimit për të verbrit. Shpenzimet për përshtatjen e banesës të mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

3. Shpenzimet operationale, që do të kryhen nga Enti Kombëtar i Banesave për banesat e ndërtuara apo të blera në tregun e lirë, të përballohen nga fondet e dhëna për strehim ose t'i njihen kësaj të fundit si shlyerje detyrimi ndaj Buxhetit të Shtetit.

4. Të verbrit e pastrehë të grupit të parë të shlyejnë diferencën ndërmjet vlerës së banesës, me përfitimet nga statusi i të pastrehut dhe nga ky vendim.

5. Kur të verbrit e grupit të parë nuk pranojnë të marrin dhomë tepër, vlera e kësaj dhome zbritet nga vlera e banesës që do të përfitojnë.

6. Kur të verbrit e pastrehë të grupit të parë, që kanë përfituar banesë nga Enti Kombëtar i Banesave, u bëhet zbritja e vlerës së përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, Enti Kombëtar i banesave nuk u detyrohet qytetarëve nëse përfitimi falas rezulton më i lartë se masa e kredisë, që ata duhet të shlyejnë.

7. Kërkesat për strehim administrohen nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, e cila përcakton radhën dhe përparësitë e trajtimit, strukturat që i takojnë çdo familjeje, duke specifikuar edhe dhomën shtesë, dhe i dërgon këto dokumente, brenda datës 1 gusht të çdo viti, pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizmit. Dokumentacioni i plotë i dërgohet Entit Kombëtar të Banesave. Ky dokumentacion përmban edhe dokumentin zyrtar të librezës së verbërisë, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë, si dhe vërtetimin nga bashkia, për statusin e të pastrehut.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.634, datë 21.11.2001**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.775, DATË 28.10.1996 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT", NDRYSHUAR ME**  
**VENDIMIN NR.77, DATË 2.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.775, datë 28.10.1996 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.77, datë 2.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) përbëhet nga 10 anëtarë:

- Kryeministrikryetar
- Ministri i Punëve Publike dhe Turizmitzëvendëskryetar
- Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit anëtar
- Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimitanëtar
- Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimitanëtar
- Ministri i Financaveanëtar
- Ministri i Transportitanëtar
- Ministri i Shëndetësisëanëtar
- Ministri i Mjedisitanëtar
- Ministri i Shtetit për Energjitikënanëtar
- Drejtori i Sekretariatit Teknik

të Këshillit Kombëtar të Ujitsekretar."

2. Vendimi nr. 77, datë 2.3.2000 i Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në vendimin nr. 775, datë 28.10.1996 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit"" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 635, datë 21.11.2001**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 337, DATË 15.7.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QEVERTAR PËR PROBLEMET UJORE ME VENDET FQINJE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.337, datë 15.7.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Komisioni kryesohet nga Zëvendësministri i Punëve Publike dhe Turizmit dhe ka në përbërje përfaqësues nga:

- Ministria e Punëve të Jashtmeanëtar
- Ministria e Rendit Publik"
- Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë"
- Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit"
- Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit"
- Ministria e Mjedisit"
- Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit"
- Ministri i Shtetit për Energjetikën"
- Akademia e Shkencave"
- Sekretariati Teknik i KKU-së"

2. Pika 3 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Titullarët e ministrave dhe institucioneve të lartpërmendura të emërojnë përfaqësuesit e tyre brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi."

3. Pika 7 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Shpenzimet për zhvillimin e veprimtarisë së komisionit dhe të nënkomisioneve (pagesat, transporti, dietat, etj.) të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizmit."

4. Pika 9 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"9. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.636, datë 21.11.2001**

**PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE TË FAMILJEVE TË SHPËRNGULURA NGA  
NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT TË BANJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", ndryshuar me ligjet nr.7828, datë 1.6.1994 dhe nr.8123, datë 9.7.1996, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Banesat e ndërtuara me fonde shtetërore për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i Hidrocentralit të Banjës dhe trualli mbi të cilin ato janë ndërtuar t'u kalojnë në pronësi, falas, familjeve, sipas listave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Privatizimi i banesave të bëhet nga Enti Kombëtar i Banesave.

3. Shpenzimet për privatizimin e këtyre banesave, që arrijnë vlerën prej 2 984 507 (dy milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesë qind e shtatë) lekësh, t'i njihen Entit Kombëtar të Banesave si shlyerje kredie për vitin 2001.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, Enti Kombëtar i Banesave, Këshilli i Qarkut të Elbasanit dhe Bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Banesa nr.1 dhe nr.2 të nisur nga ndërmarrjet të financuar dhe të përfunduara nga hidrocentrali i Banjës

Pallati nr.1 Pallati nr.2

| Nr. | Emri, mbiemri | Nr.dhomat | Nr. | Emri, mbiemri,  | Nr.dhomat |
|-----|---------------|-----------|-----|-----------------|-----------|
| 1   | Xhelal Hoxha  | 2+1       | 1   | Bashkim Mehalla | 2+1       |
| 2   | Xhevit Hoxha  | 1+1       | 2   | Sefedin Dushku  | 2+1       |
| 3   | Ylli Hoxha    | 2+1       | 3   | Veiz Hoxha      | 1+1       |
| 4   | Sali Hoxha    | 2+1       | 4   | Feti Mehalla    | 2+1       |
| 5   | Neshat Hoxha  | 2+1       | 5   | Rrapush Hoxha   | 2+1       |
| 6   | Hajdar Hoxha  | 2+1       | 6   | Shpëtim Hoxha   | 1+1       |
| 7   | Durim Hoxha   | 1+1       | 7   | Avdulla Hoxha   | 2+1       |
| 8   | Fatos Hoxha   | 2+1       | 8   | Rrahman Muca    | 2+1       |
| 9   | Landir Hoxha  | 1+1       | 9   | Olsi Muca       | 1+1       |
| 10  | Halit Hoxha   | 2+1       | 10  | Agim Muca       | 2+1       |
| 11  | Bektash Hoxha | 2+1       | 11  | Faik Mema       | 2+1       |
| 12  | Qendrim Hoxha | 1+1       | 12  | Shahin Mema     | 1+1       |
| 13  | Hamet Tarushi | 2+1       | 13  | Kadri Qose      | 2+1       |
|     |               |           | 14  | Bardhyl Mema    | 1+1       |

Pallati nr.1 Lagja "Vullnetari" 15 hyrje  
2E1-003/95

| Nr. i hyrjes | Emri, mbiemri  | Nr.dhomat | Liron ose jo |
|--------------|----------------|-----------|--------------|
| 1            | Arben Mema     | 2+1       |              |
| 2            | Nuri Kalemi    | 1+1       |              |
| 3            | Ibrahim Kalemi | 2+1       |              |
| 4            | Qani Kalemi    | 2+1       |              |
| 5            | Murat Mema     | 1+1       |              |
| 6            | Faslli Kalemi  | 2+1       |              |
| 7            | Bujare Kalemi  | 2+1       |              |
| 8            | Seit Mema      | 1+1       |              |

|    |                 |     |  |
|----|-----------------|-----|--|
| 9  | Nazif Mema      | 2+1 |  |
| 10 | Ruzhdi Kalemi   | 2+1 |  |
| 11 | Guximtar Kalemi | 1+1 |  |
| 12 | Yzeir Mema      | 2+1 |  |
| 13 | Sose Muca       | 1+1 |  |
| 14 | Zydi Qosja      | 1+1 |  |
| 15 | Ramadan Qosja   | 2+1 |  |

Pallati nr.2 Lagja "Vullnetari" 20 hyrje

2EL-006/95

| Nr. i hyrjes | Emri, mbiemri  | Nr.dhomat | Liron ose jo |
|--------------|----------------|-----------|--------------|
| 1            | Mustafa Qosja  | 1+1       |              |
| 2            | Shamet Qosja   | 2+1       |              |
| 3            | Mustafa Qosja  | 1+1       |              |
| 4            | Qamil Hoxha    | 1+1       |              |
| 5            | Ramazan Hoxha  | 2+1       |              |
| 6            | Qamil Hoxha    | 1+1       |              |
| 7            | Baftjar Kalemi | 1+1       |              |
| 8            | Kadri Mema     | 1+1       |              |
| 9            | Përparim Mema  | 2+1       |              |
| 10           | Baftjar Kalemi | 1+1       |              |
| 11           | Gani Qosja     | 1+1       |              |
| 12           | ShpëtimMehalla | 2+1       |              |
| 13           | Eduart Kalemi  | 1+1       |              |
| 14           | Elmaz Qosja    | 1+1       |              |
| 15           | Idriz Qosja    | 2+1       |              |
| 16           | Shefqet Qosja  | 2+1       |              |
| 17           | Adriatik Qosja | 1+1       |              |

Pallati nr.3 Lagja "5 Maj" 15 hyrje

2EL - 005/95

| Nr. i hyrjes | Emri, mbiemri       | Nr.dhomat | Liron ose jo |
|--------------|---------------------|-----------|--------------|
| 1            | Veiz Hoxha          | 2+1       |              |
| 2            | Armand Qosja        | 1+1       |              |
| 3            | Isuf Qosja          | 2+1       |              |
| 4            | Isa Qosja           | 2+1       |              |
| 5            | Hekuran Qosja       | 1+1       |              |
| 6            | Sefer Qosja         | 2+1       |              |
| 7            | Ismail Qosja        | 2+1       |              |
| 8            | Ardjan Qosja        | 1+1       |              |
| 9            | Hasan Shima         | 2+1       |              |
| 10           | Nazmi Hoxha         | 2+1       |              |
| 11           | Rabushe Kumria      | 1+1       |              |
| 12           | Shpëtim Hoxha       | 2+1       |              |
| 13           | Agron Hoxha         | 2+1       |              |
| 14           | Halit+Bektash Hoxha | 1+1       |              |
| 15           | Demir Hoxha         | 2+1       |              |

Pallati nr.4 Lagja "5 Maj" 15 hyrje

2EL-004/95

| Nr. i hyrjes | Emri, mbiemri | Nr.dhomat | Liron ose jo |
|--------------|---------------|-----------|--------------|
| 1            | Tahir Qosja   | 1+1       |              |
| 2            | Emin Kalemi   | 2+1       |              |
| 3            | Ilir Kalemi   | 1+1       |              |
| 4            | Nevruz Kalemi | 2+1       |              |
| 5            | Sanie Hoxha   | 1+1       |              |
| 6            | Fadil Kalemi  | 2+1       |              |

|    |             |     |  |
|----|-------------|-----|--|
| 7  | Sulo Kalem  | 2+1 |  |
| 8  | Selim Qosja | 1+1 |  |
| 9  | Luan Qosja  | 2+1 |  |
| 10 | Yzeir Kalem | 2+1 |  |
| 11 | Dalip Kalem | 1+1 |  |
| 12 | Beqir Qosja | 2+1 |  |

**V E N D I M**  
**Nr.638, datë 21.11.2001**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.64, DATË 2.2.2001 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR INKUADRIMIN E GRADAVE USHTARAKE NË GRADAT E**  
**POLICISË SË SHITIT DHE PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE QË DO TË USHTROHEN**  
**SIPAS TYRE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 22 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe të neneve 7, 8, 24 dhe 26 të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrisë të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në pikën 5 të vendimit nr.64, datë 2.2.2001 të Këshillit të Ministrave lidhja nr.2 (albumi) zëvendësohet me lidhjen nr.2 (albumi), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Forma dhe ndërtimi i gradave të policisë së Shtetit

Format e gradave të Policisë së Shtetit për të gjitha nivelet paraqiten në spaleta tekstil i posaçëm, me ngjyrë të zezë (ngjyrë qëndrueshmërie e serioziteti), me përmasat 6 x 13.7 cm (tubolare).

Gradat paraqiten me ngjyrë të artë (ngjyrë pushteti dhe triumfi).

Ndarja e gradave për të katër nivelet realizohet në mënyrë specifike brenda dhe jashtë tyre, por ajo që i bashkon ato në një pikë janë dy ngjyrat bazë: e zeza dhe ajo e artë, si dhe burimi i spaletës si në gjatësi e në gjerësi është me ngjyrë të artë. Për garantimin e cilësisë të gjithë elementët e ndërtimit të gradave janë në relief me punime e dekoracion me material plastik me bazë PVC, me termofiksion dhe të mbuluar nga përpara me veshje mbrojtëse plastike të tejdukshme, të pashqitshme.



Gradat e rolit bazë (të ulët)  
fig. 1 (Agjent)

Përbëhet nga elementi i skalionit në ngjyrë të artë.  
Ky element përdoret vetëm për këtë nivel.






Fig.2 (Agjent i parë)

Përbëhet nga elementi çift skalion në ngjyrë të artë.  
Ky element përdoret vetëm për këtë nivel.




GRADAT E ROLIT BAZË (TË ULËT)  
fig 3 (Asistent)

Përbëhet nga elementi çift+një skalion me ngjyrë të artë.  
Ky element përdoret vetëm për këtë nivel




GRADAT E ROLIT BAZË (TË ULËT)  
fig 4 (Asistent i parë)

Përbëhet nga elementi çift skalion+çift skalion me ngjyrë të artë.  
Ky element përdoret vetëm për këtë nivel.



GRADAT E ROLIT BAZË (TË ULËT)  
fig 5 (Kryeasistent)


Përbëhet nga elementi çift skalion+çift skalion+ një skalion me ngjyrë të artë.  
Ky element përdoret vetëm për këtë nivel.



#### GRADAT E ROLIT TË MESËM


Fig. 6 (Nënispektor)

Përbëhet nga një brez bazë, si dhe një yll 5 - cepësh me ngjyrë të artë.  
Ylli është 18 mm.



GRADAT E ROLIT TË MESËM  
Fig 7 (Inspektor)

Përbëhet nga një brez, si dhe dy yje 5 - cepësh me ngjyrë të artë.  
Yjet janë nga 18 mm.




#### GRADAT E ROLIT TË MESËM

Fig 8 (Kryeinspektor)


Përbëhet nga një brez bazë si dhe yje 5 - cepësh me ngjyrë të artë.

Yjet janë nga 188 mm.



GRADAT E ROLIT TË LARTË  
Fig 9 (Nënkomisar)


Përbëhet nga një yll 5 - cepësh, me ngjyrë të artë,  
shoqëruar me degëza floreale (simbol lavdie).  
Ylli është 23 mm.



#### GRADAT E ROLIT TË LARTË


Fig 10 (Komisar)

Përbëhet nga dy yje 5 - cepësh, me ngjyrë të artë,  
shoqëruar me degëza floreale (simbol lavdie).  
Yjet janë nga 23 mm.



GRADAT E ROLIT TË LARTË  
Fig 11 (Kryekomisar)


Përbëhet nga tre yje 5 - cepësh, me ngjyrë të artë,  
shoqëruar me degëza floreale (simbol lavdie).  
Yjet janë nga 23 mm.



#### GRADAT E ROLIT DREJTUES

Fig.12 (Drejtues)

Përbëhet nga një yll 5 - cepësh me ngjyrë të artë,  
një kurorë murale shoqëruar me degëza floreale (simbol lavdie).  
Ylli është 27 mm.



#### GRADAT E ROLIT DREJTUES

Foto 13 (Drejtues i Parë)

Përbëhet nga dy yje 5 - cepësh me ngjyrë të artë,  
një kurorë murale shoqëruar me degëza floreale (simbol lavdie).  
Yjet janë nga 27 mm.

**V E N D I M**  
**Nr. 640, datë 22.11.2001**

**PËR PAGAT E AVOKATURËS SË SHETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ligjit nr. 8718, datë 19.12.2000 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001" dhe të nenit 23 të ligjit nr. 8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Pagat e punonjësve të Avokaturës së Shtetit të jenë sipas pasqyrës nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për aparatin e Këshillit të Ministrave.
3. Efektet e këtij vendimi të shtrihen nga çasti i emërimit në detyrë të këtyre punonjësve. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Pasqyra nr. 1  
EMËRTESATPAGA MUJORE

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit 125 448 lekë
2. Avokatët e Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit 104 540 lekë
3. Avokatët e zyrave vendore 58 806
4. Punonjësit e tjerë të Avokaturës së Shtetit përfitojnë nivelet e pagave sipas lidhjes II-5 "Nivelet e pagave për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore" të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet nr. 39, datë 26.1.2001; nr. 158, datë 22.3.2001; nr. 167, datë 30.3.2001; nr. 174, datë 30.3.2001; nr.197, datë 6.4.2001; nr. 385, datë 31.5.2001 dhe nr. 424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave.

**V E N D I M**  
**Nr. 641, datë 22.11.2001**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 299, DATË 12.5.2001 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR REGJISTRIMIN PËR SHITJE TË SIPËRFAQEVE TË TROJEVE TË**  
**OBJEKTEVE NË PRONËSI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr. 299, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave, në lidhjen që i bashkëlidhet vendimit pas numrit rendor 10 të shtohen numrat rendor, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Procedurat dhe rregullat, që do të zbatohen nga administratorët e shoqërive huamarrëse me bashkinë apo komunën, janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të vendimit nr. 299, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Grupi Mbikëqyrës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe administratorët e shoqërive huamarrëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

**SIPËRFAQET E TROJEVE TË OBJEKTEVE PËR REGJISTRIM NË PRONËSI DHE SHOQËRIVE HUAMARRËSE DHE VLERA E TRUALLIT PËR PAGESË NË BUXHETIN E BASHKISË APO TË KOMUNËS**

| Nr. | Objektet                                               | Shoqëria në administrim | Sipërfaqja e tokës në m2 | Çmimi i truallit në m2 | Vlera e truallit për lekë |
|-----|--------------------------------------------------------|-------------------------|--------------------------|------------------------|---------------------------|
| 11. | Objekti serra, Vlorë                                   | "Kamberi"               | 30 000                   | 160                    | 4 800 000                 |
| 12. | Magazinë ambalazhi në ish-ndërmarrjen ushqimore, Vlorë | "Kamberi"               | 3 250                    | 160                    | 520 000                   |
| 13. | Ish-ndërmarrja e bonifikimit, Vlorë                    | "Silva"                 | 12 500                   | 160                    | 2 000 000                 |
| 14. | Ish-reparti i traktorëve me zinxhirë                   | "Vefa Holding"          | 2 995                    | 160                    | 479 200                   |
| 15. | Ish-reparti i restaurimit të traktorëve N.M. bujqësore | "Vefa Holding"          | 663                      | 160                    | 106 080                   |

**V E N D I M**

**Nr. 644, datë 21.11.2001**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.481, DATË 19.7.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA PËR VITIN AKADEMIK 2001-2002 NË SISTEMIN ME SHKËPUTJE NGA PUNA, SI EDHE TARIFËN E SHKOLLIMIT PO PËR VITIN AKADEMIK 2001-2002", TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.566, DATË 22.10.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 dhe 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.481, datë 19.7.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me vendimin nr.566, datë 22.10.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën "a" të pikës 2, kuota e pranimeve nga 7512 bëhet 7746, ndërsa kuota për degë të dytë dhe vite të ndërmjetme nga 250 bëhet 252.

2. Në shkronjën "b" të pikës 2 kuota kryesore nga 6539 bëhet 6714, ndërsa kuota dytësore nga 526 bëhet 583.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 648, datë 22.11.2001**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE",  
NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.39, DATË 26.1.2001; NR.158, DATË 22.3.2001; NR.167  
DATË 30.3.2001; NR.174, DATË 30.3.2001; NR.197, DATË 6.4.2001; NR.385, DATË 31.5.2001  
DHE NR.424, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001; nr.158, datë 22.3.2001; nr.167, datë 30.3.2001; nr.174, datë 30.3.2001; nr.197, datë 6.4.2001; nr.385, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave në lidhjen I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", në klasifikimin B3 të shtohen emërtimet "specialist" në Departamentin e Integritit dhe "specialist" në Departamentin e Koordinimit në Këshillin e Ministrave.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për aparatin e Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.11.2001.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 653, datë 21.11.2001**

**PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË, TË  
INTERESUAR PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME  
"ALBTELECOM"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të nenit 5 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom" sh.a.", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Forma e tenderit për përzgjedhjen e investorëve strategjikë, të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime "Albtelecom", të jetë tenderi i hapur ndërkombëtar me një fazë.

2. Ndërmjet investorëve, që do të kenë dërguar shprehjen e interesit, duke përmbushur kërkesat e treguara në njoftimin publik, të publikuar në përputhje me vendimin nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë", ftesa për tender t'u dërgohet vetëm kandidatëve, që përmbushin kërkesat e parashikuara në kapitullin III të këtij vendimi, sipas afateve të parashikuara në të.

3. Investorët strategjikë të interesuar, që do të ftohen të paraqesin ofertat e tyre më të

hollësishme, të detyrueshme, duhet të përmbushin, paraprakisht, kërkesat e mëposhtme:

-Të jenë shoqëri aksionere apo persona juridikë të ngjashëm, sipas ligjit përkatës, të krijuara sipas legjislacionit të vendit dhe të regjistruara pranë autoriteteve përkatëse ku ndodhet selia. Do të pranohen edhe bashkime, të përbëra nga shoqëri aksionere apo persona juridikë, sipas ligjit përkatës, si edhe kombinimet e investorëve, që veprojnë së bashku si konsorcium për qëllimet e kësaj blerjeje apo që synojnë të kryejnë transaksionin, nëpërmjet një shoqërie që do të krijohet ("Shoqëria e re").

-Të mos jenë aksionerë apo ortakë, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të operatorëve telefonikë kombëtarë, që veprojnë në Shqipëri.

-Të kenë një kapital tërësisht të paguar, mbi 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) USD apo barazvlerën e shumës në valutë, në të cilën është shprehur kapitali; vlera neto dhe, sipas rastit, vlera neto e konsoliduar, duhet të jetë të paktën 300 000 000 (treqind milionë) USD.

-Të jenë shoqëri të specializuara në fushën e telekomunikacioneve, të cilat kanë siguruar shërbime telekomunikacioni për jo më pak se 2 (dy) vjet; në rast të konsorciumeve apo bashkimit të investorëve, anëtar i kryesor të përmbushë kërkesat e përmendura.

- Nuk do të pranohen në procedurën e tenderit palët, të cilat janë në likuidim apo nuk kanë aftësi paguese, që janë nën administrim apo në procedime të tjera, të ngjashme, apo në ndonjë procedim, që nënkupton paaftësi paguese apo ndërprerje të biznesit.

- Në rastin e kombinimit të investorëve strategjikë me investitorë financiarë, investitori strategjik duhet të ketë kontrollin e aksioneve.

4. Të gjitha këto kërkesa të vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse, ose me anë të dokumenteve të tjera, të shkruara, zyrtare.

5. Pas analizës së shprehjeve të interesit dhe pas verifikimit për përmbushjen e kërkesave të mësipërme prej investorëve të interesuar, shoqëria këshilluese do t'i paraqesë, për miratim, Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës listën e investorëve, të cilëve do t'u dërgohet ftesa për tender.

6. Në përputhje me kapitullin II të vendimit nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investorëve strategjikë dhe transferimin e aksionerëve, të zotëruara nga shteti, në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhrin përkatës.

7. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me urdhrë të motivuar dhe të bazuar në legjislacionin në fuqi, ruan, në çdo çast, të drejtën:

a) të tërhiqet nga procesi i shitjes apo ta ndërpresë atë;

b) të përjashtojë ndonjë palë të interesuar nga procesi i shitjes, ku kjo e fundit nuk gëzon të drejtën për t'u kompensuar apo dëmshpërblyer nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtar.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

## **V E N D I M**

**Nr. 654, datë 21.11.2001**

### **PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "PËR KRIJIMIN , ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS", MIRATUAR ME VENDIMIN NR.394, DATË 27.7.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963 "Për kujdesin shëndetësor", të ligjit nr.8380, datë 29.7.1998 "Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e rimëkëmbjes së sistemit shëndetësor", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

## **V E N D O S I:**

Miratimin e disa ndryshimeve, në rregulloren "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e

autoritetit shëndetësor rajonal të Tiranës", miratuar me vendimin nr.394, datë 27.7.2000 të Këshillit të Ministrave, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

Ndryshimet në rregulloren "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e autoritetit shëndetësor rajonal të Tiranës".

1. Pika 1 e kapitullit II "Burimet financiare dhe menaxhimet e tyre" të riformulohet si më poshtë vijon:

"1.ASHR-ja e Tiranës të financohet nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, për administratën dhe shërbimet e tjera që nuk kanë kontratë me ISKSH-në."

2. Pika 1 e kapitullit III, "Organet drejtuese", të riformulohet si më poshtë vijon:

Bordi ka në përbërje të vet katër anëtarë (në asnjë rast vetë Ministri), të emëruar nga Ministri i Shëndetësisë një përfaqësues i Ministrisë së Financave, kryetarin e bashkisë së qytetit (ose një përfaqësues nga bashkia), një përfaqësues nga qarku, një përfaqësues nga prefektura, një përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH), një përfaqësues nga Njësia Ekzekutive e Projekteve të Bankës Botërore pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorin Ekzekutiv të ASHR-së".

3. Pika 4 e kapitullit VII "Drejtori ekzekutiv-emërimi dhe afati" të riformulohet si më poshtë vijon:

"4. Drejtori ekzekutiv mund të shkarkohet para afatit nga detyra nga Bordi ose Ministri, kur kryen veprime ose mosveprime, që janë në kundërshtim me ligjet, aktet dhe rregulloren e ASHR-së."

4. Pika 8 e kapitullit VIII të riformulohet si më poshtë vijon:

"8. I propozon Bordit kandidaturat e drejtorëve të drejtorive të ASHR-së, të cilat, pasi kanë marrë miratimin e Bordit, emërohen nga Ministri i Shëndetësisë. E njëjta rrugë ndiqet edhe për shkarkimin e tyre."

5. Pika 1 e kapitullit XIII të riformulohet si më poshtë vijon:

"1. Përgjegjësit e poliklinikave, mjekët, infermierët dhe pjesa tjetër e stafit të poliklinikave dhe të qendrave shëndetësore punësohen nga drejtori ekzekutiv, në mbështetje të akteve ligjore në fuqi."

6. Pika 2 e kapitullit XIII të riformulohet si më poshtë vijon:

"2. Punonjësit e poliklinikave dhe të qendrave shëndetësore paguhën nga fondi i ISKSH-së, i cili është blerës i shërbimeve bazë të kontratave, që do të lidhë ASHR-ja dhe DSKSH-ja e Tiranës për çdo poliklinikë dhe qendrës shëndetësore."

7. Pika 3 e kapitullit XIV shfuqizohet.

## **V E N D I M**

### **Nr.656, datë 21.11.2001**

## **PËR SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të vendimit nr.152, datë 5.4.1994 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

## **V E N D O S I:**

1.T'u jepet shtesë pensioni të posaçëm shtetëror në masën 8 800 (tetë mijë e tetë qind) lekë në muaj personave sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare të përballohen nga fondet për këtë qëllim të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**LISTA EMËRORE PËR PENSIONE TË POSAÇME SHTETËRORE**

1. Piro Dodbiba
2. Qamil Poda
3. Arif Hasko Memaj
4. Adnan Qatipi
5. Myqerem Fuga
6. Nikollaq Sallabanda
7. Thoma Xhixho
8. Ziqiri Mero
9. Sali Verdha
10. Sul Domi
11. Ciril Pistoli
12. Ismail Çaushti
13. Muharrem Kokomani
14. Kapo Kapaj
15. Mahmut Agolli
16. Hamdi Sollaku
17. Zeqi Agolli
18. Gjon Banushi
19. Avni Buxheli
20. Shahin Ruka
21. Emine Bahja
22. Liri Belishova
23. Rahman Perllaku
24. Fadil Paçrami
25. Enver Begeja
26. Njazi Jaho
27. Todi Lubonja

**U D H Ë Z I M**  
**Nr.7, datë 21.11.2001**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË  
NDËRTIMIT", NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN NR.4, DATË 17.5.2001 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 12 dhe 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**U D H Ë Z O N:**

Në udhëzimin nr.4, datë 17.5.2001 të Këshillit të Ministrave fjalja e dytë e paragrafit të parë të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Mbikëqyrësi i punimeve emërohet nga investitori".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
  - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 1.12.2001  
Doli nga shtypi më 4.12.2001

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4230 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë